



Prishtinë: 04 nëntor 2008  
Kodi i ZRRE-së: V\_128\_2008

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 15, 26 dhe 31 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat e Nenit 37 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
3. Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.
4. Kërkesën për vazhdim të licencës për furnizim/tregti me energji elektrike, të bërë me datë 26.05.2008 nga ndërmarrja Energy Financing Team AG ("EFT"), adresa: Gugghaldenstrasse 2, 9000 St. Galen, Zvicër:

Në mbledhjen e mbajtur më 04 nëntor 2008 nxori këtë:

### VENDIM

- I. **VAZHDOHET** vlefshmëria e licencës për furnizim/tregti me energji elektrike e ndërmarrjes "EFT", Nr ZRRE\_Li\_01/06 për periudhën nga **04 tetor 2008** deri më **04 tetor 2010**.

### Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 26.05.2008 ka pranuar me postë të rregullt nga ndërmarrja "EFT" kërkesën për vazhdim të licencës për Furnizim/Tregti me energji elektrike. Vlefshmëria e licencës së kësaj ndërmarrje ka qenë prej datës **04 tetor 2006** deri **04 tetor 2008**. Licenca vazhdohet edhe për dy vjet tjera duke filluar nga data e skadimit të periudhës fillestare (04 tetor 2008) të vlefshmërisë së licencës.
2. Ndërmarrja "EFT" e licencuar nga ZRRE-ja për furnizim/tregti me energji elektrike, mund të kryej vetëm aktivitetin e **tregtisë** së energjisë elektrike në Kosovë,
3. Nëse i Licencuari dëshiron të zhvillojë edhe aktivitete të **furnizimit** me energji elektrike, sipas Nenit 4 të licencës (ZRRE\_Li\_01/06), ai duhet të ri-aplikojë, duke plotësuar aplikacionin për licencim në Zyrën e Rregullatorit për Energji, pjesën që i referohet aktiviteteve të furnizimit.
4. ZRRE ka vlerësuar kërkesën e ndërmarrjes EFT dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



5. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
6. Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij nga Bordit i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij Vendimi pala mund të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit.

**Bordi i ZRRE**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

---

Theranda Beqiri, anëtare